



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

MINISTRI

**PËRGJIGJE SHKRESËS SË OECD-së TË DATËS 27 MARS 2018
PËR BËRJEN PALË NË PROJEKTIN BEPS**

Datë, _____ 2019, Tiranë, Shqipëri

I nderuar Sekretar i Përgjithshëm,

Kam nderin të konfirmoj marrjen e shkresës suaj të datës 27 mars 2018 me anë të së cilës Shqipëria ftohet për të marrë pjesë në Projektin BEPS si Partnere e Asociuar për kohëzgjatjen e Projektit.

Kam nderin t'iu informoj se shkresa juaj dhe kjo përgjigje përbëjnë pranimin nga Shqipëria të ftesës suaj dhe të termave dhe kushteve të përcaktuara në të, duke theksuar se kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas njoftimit nga Shqipëria, me rrugë diplomatike, se të gjitha kërkesat ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë plotësuar.

Me pranimin e ftesës suaj, Shqipëria i bashkohet Anëtarëve të Projektit BEPS në angazhimin e tyre ndaj paketës gjithëpërfshirëse BEPS dhe zbatimit të saj të qëndrueshëm, duke theksuar se afati i zbatimit mund të ndryshojë për të pasqyruar nivelin e zhvillimit të vendeve dhe juridiksioneve.

Me respekt,

**Ministri i Financave dhe Ekonomisë
i Republikës së Shqipërisë****ANILA DENAJ**

Plani i Veprimit për Erozionin e Bazës së Tatueshme dhe Transferimin e Fitimeve (BEPS)

PLANI I VEPRIMIT PËR EROZIONIN E BAZËS DHE TRANSFERIMIN E FITIMEVE – © OECD 2013

Ju lutem citoni këtë botim si:

OECD (2013), *Plani i Veprimit për Erozionin e Bazës dhe Transferimin e Fitimeve*, OECD Publishing.
<http://dx.doi.org/10.1787/9789264202719-en>

Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë

***Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie
Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service***

Akronimet dhe shkurtime:

BEPS	Erozioni i bazës së tatueshme dhe transferimi i fitimeve
CFC	Shoqëri e huaj e kontrolluar
FDI	Investime të huaja të drejtpërdrejta
MAP	Procedurë marrëveshjeje e përbashkët
MNE	Ndërmarrje shumëkombëshe
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PE	Seli e Përhershme
TVSH	Tatim mbi vlerën e shtuar
TVSH/GST	Tatim mbi vlerën e shtuar/Taksë për mallra dhe shërbime

VEPRIMI 1***Trajtimi i sfidave tatimore të ekonomisë dixhitale***

Identifikoni vështirësitë kryesore që paraqet ekonomia dixhitale për zbatimin e rregullave tatimore ndërkombëtare ekzistuese dhe zhvilloni opsionet e detajuara për trajtimin e këtyre vështirësive, duke ndërmarrë një qasje holistike dhe duke marrë në konsideratë tatimin e drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë. Çështjet që do të analizohen përfshijnë, por nuk kufizohen në aftësinë e një shoqërie për të pasur një prani të rëndësishme dixhitale në ekonominë e një vendi tjetër pa detyrime tatimore për shkak të mungesës së lidhjes sipas rregullave aktuale ndërkombëtare, atributit të vlerave të krijuara nga gjenerimi i të dhënave të tregtueshme të përshtatshme për vendndodhjen nëpërmjet shfrytëzimit të produkteve dhe shërbimeve dixhitale, karakterizimit të të ardhurave që rrjedhin nga modele të reja biznesi, zbatimit të rregullave përkatëse që lidhen me burimet dhe mënyrën si të siguroni mbledhjen efikase të TVSH-së/GST-së në lidhje me furnizimin ndërkufitar të mallrave dhe shërbimeve dixhitale. Këto punë do të kërkojnë një analizë të plotë të modeleve të ndryshme të biznesit në këtë sektor.

VEPRIMI 2***Neutralizimi i efekteve të masave hibride të mospërputhjes***

Zhvilloni dispozitat e një modeli traktati dhe rekomandimet në lidhje me hartimin e rregullave vendase për të neutralizuar efektin (p.sh. mos-taksimi i dyfishtë, zbritja e dyfishtë, shtyrja afatgjatë) e instrumenteve dhe subjekteve hibride. Kjo mund të përfshijë: (i) ndryshimet në Modelin e Konventës Tatimore të OECD-së për të siguruar se nuk përdoren instrumente dhe subjekte hibride (si dhe subjekte rezidente të dyfishta) për të marrë përfitimet e traktateve në mënyrë jo të duhur; (ii) dispozitat e ligjit vendas që parandalojnë përjashtimin ose mos-njohjen e pagesave që janë të zbritshme nga paguesi; (iii) dispozitat e ligjit vendas që mohojnë një zbritje për një pagesë që nuk mund të përfshihet në të ardhura nga marrësi (dhe nuk i nënshtrohet tatimit sipas rregullave për shoqëri të huaja të kontrolluara (CFC) ose të ngjashme); (iv) dispozitat e ligjit vendas që mohojnë një zbritje për një pagesë që është gjithashtu e zbritshme në një juridiksion tjetër; dhe (v) në rastet e nevojshme, udhëzime për koordinimin ose rregulla shtesë, nëse më shumë se një vend kërkon të zbatojë rregulla në një transaksion ose strukturë. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ndërveprimit midis ndryshimeve të mundshme në ligjin vendas dhe dispozitave të Modelit të Konventës Tatimore të OECD-së. Kjo punë do të koordinohet me punën për kufizimet e zbritjes së shpenzimeve të interesit, punën për rregullat e CFC-së dhe punën për “treaty shopping” (Praktika e strukturimit të një biznesi shumëkombësh

për të përfituar nga traktatet tatimore më të favorshme në dispozicion në juridiksione të caktuara).

VEPRIMI 3

Fuqizimi i rregullave për shoqëritë e huaja të kontrolluara (CFC)

Hartoni rekomandime në lidhje me formulimin e rregullave për shoqëritë e huaja të kontrolluara. Kjo punë do të koordinohet me punë të tjera, si të jetë e nevojshme.

VEPRIMI 4

Kufizimi i erozionit të bazës së tatueshme nëpërmjet uljeve të interesave dhe pagesave të tjera financiare.

Hartoni rekomandime në lidhje me praktikën më të mira në formulimin e rregullave për të parandaluar erozionin e bazës së tatueshme nëpërmjet përdorimit të shpenzimeve të interesit, për shembull nëpërmjet shfrytëzimit të borxhit të palës përkatëse dhe të palës së tretë për të arritur zbritje të tejskajshme interesash ose për të financuar prodhimin e të ardhurave të përjashtuara ose të shtyra dhe pagesa të tjera financiare që janë ekonomikisht të barazvlefshme me pagesat e interesave. Puna do të vlerësojë efikasitetin e llojeve të ndryshme të kufizimeve. Në lidhje me dhe në mbështetje të punës së lartpërmendur, do të hartohet gjithashtu udhëzuesi për çmimet e transferimit në lidhje me çmimet e transaksioneve financiare të palës përkatëse, duke përfshirë garancitë financiare dhe ato të performancës, derivatet (duke përfshirë derivatet e brendshme që përdoren në marrëdhëniet ndër-bankare) dhe masat e kontrolluara dhe masa të tjera të kontrolluara. Puna do të koordinohet me punën për rregullat hibride dhe të CFC-së.

VEPRIMI 5

Kundërshtimi i praktikave të dëmshme tatimore në mënyrë më efikase, duke marrë në konsideratë transparencën dhe thelbin/përmbajtjen

Riorganizoni punën për praktikën tatimore të dëmshme, me prioritet përmirësimin e transparencës, duke përfshirë shkëmbimin e detyrueshëm spontan për rregullat që lidhen me regjimet preferenciale dhe që kërkojnë aktivitet themelor për çdo regjim preferencial. Do të nevojitet një qasje holistike për të vlerësuar regjimet preferenciale tatimore në kontekstin e BEPS-së. Ajo do të angazhohet me anëtarët jo-OECD mbi bazën e kuadrit ekzistues dhe merrni në konsideratë rishikime ose shtesa në kuadrin ekzistues.

VEPRIMI 6

Parandalimi i abuzimit me traktatet

Hartoni modele dispozitash dhe rekomandimesh për traktate në lidhje me formulimin e rregullave vendase për të parandaluar dhënien e përfitimeve të traktateve në rrethana jo të përshtatshme. Puna do të kryhet gjithashtu për të sqaruar se traktatet tatimore nuk synojnë të përdoren për të gjeneruar mos-taksim të dyfishtë dhe për të identifikuar vlerësimet e politikave tatimore që, në përgjithësi shtetet duhet të konsiderojnë përpara se të vendosin për të lidhur një traktat tatimor me një vend tjetër. Puna do të koordinohet me punën për hibridet.

VEPRIMI 7

Parandalimi i shmangies artificiale të statusit PE (selia e përhershme)

Kryeni ndryshimet në përkufizimin e PE-ve për të parandaluar shmangien artificiale të statusit PE në lidhje me BEPS-në, duke përfshirë shfrytëzimin e masave të komisionerit dhe përjashtimet e aktiviteteve specifike. Puna për këto çështje do të trajtojë gjithashtu çështjet që lidhen me atribuimin e fitimit.

VEPRIMET 8, 9, 10

Sigurimi se rezultatet e çmimeve të transferimit janë në përputhje me krijimin e vlerave

VEPRIMI 8 – Asetet jo-materiale

Hartoni rregulla për të parandaluar BEPS-në, duke kryer lëvizje të aseteve jo-materiale midis anëtarëve të grupit. Kjo do të përfshijë: (i) miratimin e një përkufizimi të gjerë dhe të përcaktuar qartë të aseteve jo-materiale; (ii) sigurimin se fitimet që lidhen me transferimin dhe përdorimin e aseteve jo-materiale shpërndahen në mënyrë të duhur në përputhje me (sesa të shkëputura nga) krijimin e vlerave; (iii) hartimin e rregullave për çmimin e transferimit ose masave të posaçme për transferime të aseteve jo-materiale të vështira për t'u vlerësuar; dhe (iv) përditësimin e udhëzimeve për masat e kontributit të kostos.

VEPRIMI 9 – Risqet/rreziqet dhe kapitali

Hartoni rregulla për të parandaluar BEPS-në, duke kryer transferime risqesh ndërmjet, ose duke shpërndarë kapital të tepërt tek anëtarët e grupit. Kjo do të përfshijë miratimin e rregullave të çmimeve të transferimit ose masat e posaçme për të siguruar se kthime të papërshtatshme nuk do të akumulohen tek një subjekt meqë ai ka marrë përsipër risqe në mënyrë kontraktuale ose ka dhënë kapital. Rregullat që duhet të zhvillohen/hartohen do të kërkojnë gjithashtu përafrimin e kthimeve me krijimin e vlerave. Kjo punë do të koordinohet me punën për zbritjet e shpenzimeve të interesit dhe pagesa të tjera financiare.

VEPRIMI 10 – Transaksione të tjera me risk/rrezik të lartë

Hartoni rregulla për të parandaluar BEPS-në, duke u angazhuar në transaksione që nuk do të ndodhnin ose do të ndodhnin shumë rrallë ndërmjet palëve të treta. Kjo do të përfshijë miratimin e rregullave të çmimeve të transferimit ose masat e posaçme: (i) për të sqaruar rrethanat në të cilat transaksionet mund të ri-karakterizohen; (ii) për të sqaruar zbatimin e metodave të çmimeve të transferimit, në mënyrë të veçantë të ndarjeve të fitimit, në kontekstin e zinxhirëve globalë të vlerave; dhe (iii) për të dhënë mbrojtje ndaj llojeve të zakonshme të pagesave të erozionit të bazës së tatueshme, siç janë tarifatat e menaxhimit dhe shpenzimet e selisë qendrore.

VEPRIMI 11

Përcaktimi i metodologjive për të mbledhur dhe analizuar të dhëna për BEPS-në dhe veprimet për t'iu adresuar atij

Hartoni rekomandime në lidhje me treguesit e shkallës dhe ndikimin ekonomik të BEPS-së dhe siguron se instrumentet janë të disponueshme për të monitoruar dhe vlerësuar efektshmërinë dhe ndikimin ekonomik të veprimeve të ndërmarra për t'iu adresuar BEPS-së në mënyrë të vazhdueshme. Kjo do të përfshijë zhvillimin e një analize ekonomike të shkallës dhe ndikimit të BEPS-së (duke përfshirë efektet e pasojave të papritura nëpër vende të ndryshme) dhe veprimet për t'ju adresuar atij. Puna do të përfshijë gjithashtu vlerësimin e një serie burimesh të dhënash ekzistuese, duke identifikuar lloje të reja të dhënash që duhet të mblidhen dhe duke zhvilluar metodologji bazuar në të dhëna agregate (p.sh. FDI dhe balanca e të dhënave të pagesave) dhe të dhëna të nivelit mikro (p.sh. nga pasqyrat financiare dhe kthimet e taksave), duke marrë në konsideratë nevojën për të respektuar konfidencialitetin e tatimpaguesit dhe kostot administrative për administratat tatimore dhe bizneset.

VEPRIMI 12

Kërkesa ndaj taksapaguesve që të parashtrojnë masat e planeve të tyre agresive tatimore

Hartoni rekomandime në lidhje me formulimin e rregullave të detyrueshme të njoftimit për transaksione agresive ose abuzive, masa ose struktura, duke marrë në konsideratë kostot administrative për administratat tatimore dhe bizneset dhe duke nxjerrë përvoja të numrit në rritje të vendeve që kanë rregulla të tilla. Puna do të shfrytëzojë një projekt modular që lejon qëndrueshmëri maksimale, por lejon nevoja dhe rreziqe specifike për vendet. Në fokus do të jenë skemat tatimore ndërkombëtare, ku puna do të eksplorojë përdorimin e një përkufizimi të gjerë të “përfitimit tatimor” për të tërhequr transaksione të tilla. Puna do të koordinohet me punën për pajtueshmërinë bashkëpunuese. Ajo do të përfshijë gjithashtu hartimin dhe zbatimin e modeleve

të përmirësuar të informacionit që shpërndahet për skemat tatimore ndërkombëtare ndërmjet administratave tatimore.

VEPRIMI 13

Ri-analizimi i dokumentacionit të çmimeve të transferimit

Hartoni rregulla në lidhje me dokumentacionin e çmimit të transferimit për të përmirësuar transparencën për administratën tatimore, duke marrë në konsideratë kostot e pajtueshmërisë për biznesin. Rregullat që duhet të hartohen do të përfshijnë një kriter që MNE t'i sigurojë të gjitha qeverive përkatëse informacionin e nevojshëm për shpërndarjen globale të të ardhurave të tyre, aktivitetin ekonomik dhe taksat e paguara ndërmjet vendeve sipas një modeli të zakonshëm.

VEPRIMI 14

Rrisni efikasitetin e mekanizmave për zgjidhjen e konflikteve

Hartoni zgjidhje për të trajtuar pengesat që parandalojnë vendet që të zgjidhin konflikte që lidhen me traktatin sipas MAP-së, duke përfshirë mungesën e dispozitave të arbitrazhit në shumicën e traktateve dhe faktin që aksesin në MAP dhe arbitrazhi mund të mohohen në raste të caktuara.

VEPRIMI 15

Përgatitja e një instrumenti shumëpalësh

Analizoni çështjet e ligjit tatimor dhe ndërkombëtar publik që lidhen me zhvillimin e një instrumenti multilateral për t'i mundësuar juridiksioneve që dëshirojnë të veprojnë në këtë mënyrë, të zbatojnë masat e hartuara gjatë punës për BEPS-në dhe të amendojnë traktatet tatimore dypalëshe. Mbi bazën e kësaj analize, Palët e interesuara do të përgatisin një instrument shumëpalësh të hartuar në mënyrë që të ofrojë një qasje novatore ndaj çështjeve tatimore ndërkombëtare, duke reflektuar natyrën e shpejtë të zhvillimit të ekonomisë globale dhe nevojën për t'iu përshtatur shpejt këtij zhvillimi.